

L I G J
Nr. 8651, datë 28.7.2000

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8435, DATË 28.12.1998 “PËR
SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, NDRYSHUAR ME LIGJET
NR. 8508, DATË 7.7.1999; NR.8519, DATË 30.7.1999; NR. 8552, DATË 18.11.1999 DHE NR.
8581, DATË 17.2.2000**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave dhe të një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr. 8435, datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjet nr. 8508, datë 7.7.1999; nr.8519, datë 30.7.1999; nr. 8552, datë 18.11.1999 dhe nr. 8581, datë 17.2.2000, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 2 pika 13 ndryshohet si vijon:

“13.Taksa vjetore për shërbimet e transmetimeve radio e televizive”

Neni 2

Neni 6 shkronja “k” titulli ndryshohet:

“k) Taksa vjetore për shërbimet e transmetimeve radio e televizive”

Në fund të shkronjës “k”, pas “...përsëritës 100 000 (njëqind mijë) lekë” shtohet:

“Për lidhjet me studiot

Sistem në brezin mbi 1000 MHz

a) analog:

- | | |
|--|--------------------|
| - Për çdo kanal me gjerësi deri 1 MHz | 30 000 lekë në vit |
| - Për çdo kanal me gjerësi deri 10 MHz | 40 000 lekë në vit |
| - Për çdo kanal me gjerësi mbi 10 MHz | 60 000 lekë në vit |

b) dixhital:

- | | |
|-------------------------------|--------------------|
| - Për kapacitet deri 128 kb/s | 5 000 lekë në vit |
| - Për kapacitet deri në 2mb/s | 20 000 lekë në vit |
| - Për kapacitet deri 8 mb/s | 30 000 lekë në vit |
| - Për kapacitet deri 34 mb/s | 40 000 lekë në vit |
| - Për kapacitet mbi 34 Mb/s | 50 000 lekë në vit |

Neni 3

Neni 9 shkronja “j” ndryshohet:

“j).Për taksën vjetore për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive ngarkohet Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT).”

Neni 4

Lidhjet e ligjit nr. 8435, datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë” ndryshohen si vijon:

Në lidhjen nr.7 pika v, titulli ndryshohet:

“v.Shërbimi fiks për operatorët e telekomunikacioneve”

Lidhja 10 e ligjit ndryshon sipas lidhjes që i bashkëngjitet këtij ligji.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare

Shpallur me dekretin nr.2722, datë 3.8.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

LIDHJA NR.10
TAKSA MUJORE E SOLIDARITETIT PËR RENDIN DHE MBROJTJEN

	Lekë
1. Subjektet shtetërore të regjistruara në TVSH	100 000
2. Filialet e subjekteve shtetërore të regjistruara në TVSH	5 000
3. Subjektet me kapital të përbashkët (shtet-privat)	50 000
4. Subjektet private të regjistruara në TVSH	5 000
5. Filialet e subjekteve private të regjistruara në TVSH që ushtrojnë veprimtarinë e tyre jashtë qendrës administrative të subjektit kryesor	2 000
6. Biznesi i vogël në qytet Përfshihen nga pagesa e taksës së solidaritetit të gjitha subjektet e biznesit të vogël që zhvillojnë tregti ambulante në tregjet e miratuara nga organet e pushtetit vendor.	1 000
7. Biznesi i vogël në fshat	500